




Nr. 13 prot
Shkodër, 12/03/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 7 Datë 07.03.2018

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “TRADITA GEG & TOSK” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit “TRADITA GEG & TOSK” sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**TRADITA GEG & TOSK**”sh.p.k., me administrator Z.Sami BRAHIMI, për përdorim të burimeve ujor **Përroi Kroi i Borshit dhe Përroi i Bicës**, (degë të Lumit të Shalës) për prodhim energjie elektrike në fshatin Gimaj, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC ERA 1 do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes nr.1: (Kroi Borshit)	$X_1 - 43\ 99\ 667;$	$Y_1 - 46\ 87\ 263;$	$Z_1 - + 508\ m;$
Koordinatat e veprës së marrjes nr.2: (Kroi Borshit)	$X_2 - 43\ 99\ 506;$	$Y_2 - 46\ 87\ 493;$	$Z_2 - + 508\ m;$
Koordinatat e veprës së marrjes nr.3: (Përroi Bicës)	$X_3 - 43\ 99\ 106;$	$Y_3 - 46\ 88\ 050;$	$Z_3 - + 508\ m;$
Koordinatat e Burimit 1. Kaptazhit 1:	$X_1 - 43\ 99\ 192;$	$Y_1 - 46\ 87\ 954;$	$Z_1 - + 508\ m;$
Koordinatat e godinës së centralit:	$X - 44\ 000\ 33;$	$Y - 46\ 87\ 853;$	$Z - + 380\ m;$
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	$X - 44\ 000\ 33;$	$Y - 46\ 87\ 853;$	$Z - + 380\ m;$
Prurja mesatare vjetore e burimeve:	$Q_{1mes}=0.168\ m^3/sek;$	$Q_{2mes}=0.055\ m^3/sek;$	$Q_{3mes}=0.436\ m^3/sek;$
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:	$Q\ llog = 0.76\ m^3/sek;$		
Prurja ekologjike:	$Q\ ekol = 0.135\ m^3/sek;$		
Prurja që shkarkohet:	$Q = 0.76\ m^3/sek.$		

2- Autorizimi(miratimi në parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR
Raimonda GURI



KRYETAR
Çesk MILLJA

